



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:292182

Datë: 28.04.2021

Numri i dokumentit: 01741914

P.nr.283/19

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.D. ngapër shkak të veprës penale: në bashkëveprim sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 parag. 1 lidhur me nenin 31 i KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1998/2019, të dt. 16.12.2019, në seancën gjyqësore të mbajtur më datë 21.04.2021, në prani të palëve, shpalli dhe komunikoi publikisht, ndërsa më datën 28.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

M.D., me pseudonim “.....”, nga i ati A. dhe e ëma B., mbiemri i vajzërisë B., i lindur më, në, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

Më datë 05.12.2019, rreth orës 14.30 min, në Kamenicë, përball zjarrfiksëve, i pandehuri M.D. në bashkëveprim me të miturën N.P. ka sulmuar zyrtarin policor E. G., deri sa ishte në kryerje të detyrës zyrtare, ashtu që për derisa zyrtarët policor A.P., E. G. dhe E. G.i, pas një njoftimi për një sulm fizik ndaj një femre, kishin reaguar në rast dhe me të mbërri në lokacionin e raportuar, vërejnë të pandehurit me shkuqe në fytyrat e tyre dhe të miturën duke

qarë, prandaj edhe u kërkojnë ti shoqërojnë në Stacionin Policor për intervistim dhe për derisa zyrtari policor A.P. shoqëron të pandehurin M.për ta dërguar tek vetura, e pandehura e mitur N. P. acarohet, fillon të bërtasë dhe papritmas e sulmon zyrtarin policor E. G. me duar në kokë dhe shqelma nëpër trup, përkundër se i njëjti përpiqet ta largojë duke e shtyer me duar, e pandehura e mitur e kap për rrobe ku edhe i shqyen një pjesë të uniformës, në ato momente vërsulet edhe i pandehuri M. në drejtim të tyre dhe me grushte e godet në krahëror zyrtarin policor E.G., prandaj për t'i dal në ndihmë kolegut reagon zyrtari A. P. dhe së bashku arrijnë ti vendosin në kontroll.

- me ç'rast ka kryer veprën penale: në bashkëveprim sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 parag. 1 të KPRK-së,

Gjykata në bazë të nenit të lartëcekur dhe neneve 4, 38, 42, 44, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, lidhur me nenet 365 dhe 451 të KPPRK-së, të akuzuarin M. D. e,

G J Y K O N

Me dënim me **burg efektiv** në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditëve**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **600 €**, të cilën shumë i akuzuari, do ta arkëtoi në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

Të akuzuarit, në dënimin e shqiptuar me gjobë, do ti llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 20 ditësh, edhe ate prej 05.12.2019 e deri më 24.12.2019.

Pala e dëmtuar E.G.i nga Kamenica, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari M.D., që në emër të paushallit gjyqësor të arkëtoi shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 39, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1998/2019, të dt. 16.12.2019, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit M. D. nga, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: në bashkëveprim sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 parag. 1 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datë 27.02.2020, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari M.D.ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se nuk pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Pasi që i akuzuari në afatin ligjor nuk i ka kundërshtuar provat në aktakuzë dhe nuk ka parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës, gjykata lidhur me rastin ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor për dt. 21.04.2021, në të cilën seancë gjyqësore, përkatësisht në fillim të seancës i akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktakuzës. Andaj pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktit akuzues, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtëpërdrejtë është shkuar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi në fjalën përfundimtare deklaroi se, në shqyrtimin e sotëm gjyqësor i pandehuri M. D. e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, andaj pasi që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban dhe kërkon nga gjykata që të pandehurin Mërgim Demolli ta shpallë fajtor.

I akuzuari M. D. në fjalën përfundimtare deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet, ka gabuar, i premtonte gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej kështu vepra penale apo vepra tjera penale, andaj kërkon nga gjykata që nëse eventualisht e shpall fajtor, me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë dënimit të ketë parasysh gjendjen e tij të

vështirë ekonomike, sepse si i pa punë jeton pa kurrfarë të ardhurash personale, jedhe ate vetëm nga puna e krahut – fizike, që punon herë pas here, në mënyrë që mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari M. D., me dashje ka kryer veprën penale, në bashkëveprim sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 parag. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjyqtari i vetëm gjykues pati parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, gjendjen e tij të vështirë në të cilën jeton, se është penduar thellë për veprën penale të kryer, faktin se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepër tjetër penale. Ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg, me mundësi të zavendsimi me dënim me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit ndaj të akuzuarit M. D. duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Të akuzuarit, në dënimin e shqiptuar me gjobë, do ti llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 20 ditësh, edhe ate prej 05.12.2019 e deri më 24.12.2019.

Pala e dëmtuar E. G. nga Kamenica, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarës, gjykata, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarën ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 30 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË,

P.nr.283/19 më datë. 28.04.2021

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.